



PUBLIKIM MUJOR NUMRI 70 | JANAR - SHKURT 2014

*fq. 2**ePeriodik*

Thellohet bashkëpunimi midis Autoritetit të Mbiqëyrjes Financiare dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për muajin janar 2014 *fq. 2-3*

ZHVILLIME TË TJERA

- » Mbledhje e Komitetit Rajonal Evropian të IOSCO-s *fq. 4*
(7 shkurt, Paris)
- » Mbledhje e Komitetit Teknik të IOPS dhe seminari mbi sfidat rregullatore dhe mbikëqyrëse në industrinë e pensioneve *fq. 4-5*
(26 shkurt, Islandë)
- » Seminar për mbikëqyrjen efektive të tregjeve të kapitalit *fq. 5-6*
(24-27 shkurt, Maltë)

LAJMET NGA RAJONI

- » Bullgari » Greqi *fq. 7*
- » Rusi » Rumani » Qipro *fq. 8*
- » Turqia, Rusia, Polonia dhe Republika Çeke, me mundësitë më interesante për rritje në industrinë evropiane të sigurimeve *fq. 9*
- » Sigurimet Kasko më të shtrenjta në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore *fq. 9*

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

THELLOHET BASHKËPUNIMI MIDIS AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE DHE BANKËS QENDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në kuadër të bashkëpunimit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), një delegacion nga kjo bankë bëri një vizitë pune në datën 12 shkurt 2014 pranë zyrave të AMF-së. Delegacioni kryesohej nga Z. Fehmi Mehmeti, Zëvendësguvernator për Mbikëqyrjen Financiare dhe Z. Nexhat Miftari, Drejtor i Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

Gjatë vizitës u zhvilluan takime pune me drejtuesit e lartë të AMF-së për problemet e bashkëpunimit dypalësh, në drejtim të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve respektive. Gjatë takimeve u diskutua edhe lidhur me rifreskimin e Memorandumit të Mirëkuptimit mes dy vendeve, memorandum i nënshkruar që në vitin 2008. Gjithashtu, u zhvilluan takime me drejtues të drejtorisë së inspektimit, drejtorisë së analizës dhe raportimit lidhur me teknikat, analizat financiare të shoqërive dhe ndërtimit të manualeve të mbikëqyrjes me bazë risku.

Nënkryetari i Autoritetit Z. Mati Pepa shprehu kënaqësinë që bashkëpunimi midis të dy autoriteteve ka ardhur gjithnjë duke u thelluar. Po ashtu edhe zëvendësguvernatori i BQK, Z. Mehmeti shprehu kënaqësinë që takime të tilla të përbashkëta i japin një nxitje më të madhe bashkëpunimit midis institucioneve, shkëmbimit të informacionit dhe përvojave teknike dhe profesionale për të ndërtuar strategji dhe projekte të përbashkëta për zhvillim të mëtejshëm.

Gjatë takimeve u diskutua edhe lidhur me rifreskimin e Memorandumit të Mirëkuptimit mes dy vendeve, memorandum i nënshkruar që në vitin 2008.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për muajin janar 2014

Tregu i sigurimeve u rrit me 31.35% gjatë muajit janar 2014. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë muaj arriti rreth 990 milion lekë. Numri i policave të sigurimit në muajin janar 2014, u ul me rreth 11.21% duke arritur në 72,898 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, janë dëmet e paguara bruto. Gjatë muajit janar 2014 dëmet e paguara bruto u rritën me 17.91% në krahasim me muajin janar 2013. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 157 milion lekë, apo 78.00% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Tregu i sigurimeve u rrit me 31.35% gjatë muajit janar 2014.

SIGURIMI I JO-JETËS

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 34.94% gjatë muajit janar 2014, krahasuar kjo me të njëjtën muaj të një viti më parë.

SIGURIMI I DETYRUESHËM MOTORIK

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të ketë arritur vlerën rreth 471 milion lekë gjatë muajit janar 2014, duke shënuar një rritje prej 19.60% krahasuar me muajin janar të vitit të kaluar.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik gjatë muajit janar përbën 55.09% të volumit total të primeve në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës.

KLASA TË TJERA NË SIGURIMET E JO-JETËS

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- » *zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë*, të cilat zunë 20.88% të tregut të Jo-Jetës;
- » *sigurimi i aksidenteve dhe sigurimi i shëndetit* zunë 8.14% të tregut të Jo-Jetës.

SIGURIMI I JETËS

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 4.91% krahasuar me janarin e vitit 2013. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë me kursim” dhe përbën 42.75% të volumit total të primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jetës.

NDARJA E TREGUT TË SIGURIMEVE, JANAR 2014

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



ZHVILLIME TË TJERA

Mbledhje e Komitetit Rajonal Evropian të IOSCO-s

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë, (*International Organization of Securities Commissions, IOSCO*) në bashkëpunim me Autoritetin Evropian të Letrave me Vlerë (*European Securities and Markets Authority, ESMA*) zhvilluan në datën 7 shkurt, në Paris mbledhjen e radhës së Komitetit Evropian të IOSCO-s.

Në strukturën e IOSCO-s funksionojnë edhe katër komitete të specializuara sipas rajoneve që mbledhen rregullisht për të diskutuar për problemet rajonale. Komiteti Evropian është njëri nga këto komitete, anëtare e të cilit është edhe AMF.

Kryetari i Bordit të Fondacionit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (*International Financial Reporting Standards*) prezantoi sistemin financiar rregullator. Edhe vendet e tjera pjesëmarrëse prezantuan zhvillimet e reja në kuadrin e tyre rregullator. Tematika të tjera të diskutuara lidheshin me:

- » Risqet e reja në tregjet financiare evropiane dhe pasojat në përshtatjen e politikave;
- » Tregun e këmbimit valutor dhe çështjet që lidhen me mbrojtjen e investitorëve dhe përkufizimin e derivateve të tregut e këmbimit valutor.

Gjatë mbledhjes u shkëmbyen ide lidhur me mundësitë e reja të bashkëpunimit për çështjet ndërkufitare, qeverisjen e korporatave, etj. Një vëmendje e veçantë ju kushtua edhe çështjeve të politikave të komitetit si:

- » Shndrimi i produkteve financiare në letra me vlerë;
- » Financimet afatgjata;
- » Krimi kibernetik;
- » Mbledhja e fondeve nga shumë investitorë;
- » Likuiditeti i tregut të letrave me vlerë;
- » Website statistikor.

Në mbledhje u diskutuan edhe çështjet organizative lidhur me procesin e nënshkrimit të marrëveshjeve multilaterale të bashkëpunimit prej disa organizmave anëtare të IOSCO-s.

Mbledhje e Komitetit Teknik të IOPS dhe seminari mbi sfidat rregullatore dhe mbikëqyrëse në industrinë e pensioneve

Komiteti Teknik i Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS) zhvilloi mbledhjen e tij të radhës në Islandë në datën 26 shkurt. Gjatë takimit u bënë prezantime nga autoritetet mbikëqyrëse të Polonisë, Maqedonisë dhe Ugandës. Secili prej vendeve prezantoi situatën në treg dhe ndryshimet që janë kryer në të. Në rastin e

Gjatë mbledhjes u shkëmbyen ide lidhur me mundësitë e reja të bashkëpunimit për çështjet ndërkufitare, qeverisjen e korporatave, etj.

Në takim u prezantuan konceptet për dy projekte të reja për raporte vlerësuese e studimore. Projekti i parë lidhej me mikropensionet dhe projekti i dytë lidhej me rolin e aktuarëve në mbikëqyrjen e pensioneve. Për projektin e dytë, AMF është pjesë e grupit të punës.

Ugandës u prezantua reformimi i autoritetit rregullator të pensioneve ku spikati forcimi i kapaciteteve administrative nëpërmjet shtimit të forcës së punës (nga 13 në 50), forcimi i pavarësisë së institucionit dhe dalja në tregun ndërkombëtar për të tërhequr specialistë, të cilët nuk ofrohen nga tregu i brendshëm i punës. Ky proces reformimi dhe punësimi në tregjet ndërkombëtare është mbështetur financiarisht me miratim nga Parlamenti. Në rastin e autoritetit të Maqedonisë, praktikë e dobishme ishte fakti që mbikëqyrja (*off site* dhe *on site*) realizohej nga e njëjta skuadër mbikëqyrësish.

Gjatë mbledhjes u prezantua nga FME, Islandë, vetëvlerësimi i kryer për pajtueshmërinë me Parimet Bazë të OECD-së për mbikëqyrjen e pensioneve.

Në mbledhje u diskutuan raportet e natyrës vlerësuese e studimore, të cilat ishin paraqitur për diskutim në takimin e mëparshëm në Seul. Raportet e diskutuara dhe të miratuara për publikim ishin:

- » Prova e rezistencës dhe analiza e skenarit për planet e pensionit;
- » Tarifatat dhe komisionet.

Në takim u prezantuan konceptet për dy projekte të reja për raporte vlerësuese e studimore. Projekti i parë lidhej me mikropensionet dhe projekti i dytë lidhej me rolin e aktuarëve në mbikëqyrjen e pensioneve. Për projektin e dytë, AMF është pjesë e grupit të punës.

Në vijim u zhvillua seminari mbi sfidat rregullatore dhe mbikëqyrëse në industrinë e pensioneve në Islandë. Në seminar u mbajtën prezantime mbi situatën në industrinë e pensioneve në Islandë dhe mbikëqyrjen e rregullimit të kësaj industrie, sfidat me të cilat përballen ajo, të cilat janë të njëjta me prirjen botërore, pra moshimi i popullsisë, normat e ulëta të kthimit dhe qëndrueshmëria afatgjatë e sistemit. Sfida për rastin e Islandës ishte edhe diversifikimi i investimit të aseteve të fondeve të pensionit, gjë që aktualisht është i kufizuar për shkak të kontrolleve që ekzistojnë në llogarinë e kapitalit dhe moslejimin e investimit të aseteve në tregje të huaja.

Seminar për mbikëqyrjen efektive të tregjeve të kapitalit

Autoriteti i Shërbimeve Financiare i Maltës dhe Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursave i Shteteve të Bashkuara të Amerikës organizuan në datat 24-27 shkurt, në Maltë seminarin “Për mbikëqyrjen efektive të tregjeve të kapitalit”.

Fokusi qendror i temave të trajtuara në seminar lidhej me teknikat e balancuara, të provuara dhe pragmatike për mbikëqyrjen dhe inspektimin e subjekteve të tregut të letrave me vlerë nëpërmjet kryerjes së investigimeve dhe marrjes së masave administrative efektive. Theks i veçantë u vendos në problematikat që lindin nga veprimtaria e ndërmjetësimit, këshilltarët e investimeve, shoqëritë e investimeve, fondet e investimit, fondet gardh (*hedge funds*), dhe fondet e kapitalit privat (*private equity funds*).

Lektorë në këtë seminar ishin katër ekspertë të lartë nga Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursave i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me përvojë në sektorin privat dhe publik. Në prezantimet e tyre, ata dhanë në mënyrë të detajuar praktikat më të mira ndërkombëtare, të cilat do të mund të përshtateshin për një përdorim efektiv edhe në tregjet e vendeve të tjera.

Temat kryesore të diskutuara ishin:

- » Trajnimi ndërkufitar lidhur me tregjet e kapitaleve;
- » Mashtrimi financiar;
- » Pastrimi i parave;
- » Mjetet juridike dhe sanksionet.

Të gjitha temat e trajtuara i shërbenin kryesisht qëllimit kryesor, ndërtimit të një programi sa më efektiv dhe mbikëqyrjen me bazë risku.

Diskutimet u përqendruan gjithashtu në ndërkombëtarizimin e tregjeve të letrave me vlerë dhe rritjen e frekuencës së veprimtarisë tregtare ndërkufitare, të cilat sot kanë krijuar një mjedis më të vështirë të zbatimit të ligjit. Shpesh, hetimi dhe ndjekja e shkeljeve të ligjit të letrave me vlerë në një vend kërkon mbledhjen e informacionit që gjendet jashtë atij vendi. Prandaj, është me shumë rëndësi për rregullatorët e letrave me vlerë nga e gjithë bota për të bashkëpunuar në sigurimin e informacionit të nevojshëm për parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të shkeljeve të ligjit.

Mashtrimi financiar ishte një nga temat kryesore të këtij seminari. Për këtë temë, theksi u vu në kërkesat themelore ligjore që rregullojnë raportimin financiar, burimet e informacionit nga të cilat këto hetime lindin, llojet e përbashkëta të skemave të mashtrimit financiar, dokumentet që duhet të shqyrtohen nga shoqëria dhe audituesi i shoqërisë, individët të cilët duhet të thirren për të dëshmuar, si dhe sanksionet e duhura për të adresuar këto raste. Seminari trajtoi edhe tema të tjera si mjetet juridike dhe sanksionet për shkeljet e ligjit të letra me vlerë, duke treguar mjetet që Komisioni i Letrave me Vlerë i SHBA-së (*United States Securities & Exchange Commission, SEC*) ka për të luftuar shkeljet e ligjit.

Ky ishte seminari i dytë për mbikëqyrjen efektive në tregjet e kapitaleve i zhvilluar në Maltë në bashkëpunim me SEC. Seminari shërbeu si një forum dinamik ku folësit dhe përfaqësuesit nga mbi 20 juridiksione të ndryshme ndërkombëtare shkëmbyen eksperiencën dhe diskutuan objektiva dhe filozofi që promovojnë mbrojtjen e investitorëve dhe integritetin e tregjeve të kapitalit.

Theks i veçantë u vendos në problematikat që lindin nga veprimtaria e ndërmjetësimit, këshilltarët e investimeve, shoqëritë e investimeve, fondet e investimit, fondet gardh (*hedge funds*), dhe fondet e kapitalit privat (*private equity funds*).

LAJMET NGA RAJONI

BULLGARI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave zyrtare të publikuara nga Ministria e Punëve të Brendshme, numri i vjedhjeve të makinave u rrit me 23% në vitin 2013. Të dhënat e siguruesve tregojnë se makina të vjedhura më shpesh në Bullgari janë BMW-të.

Drejtues të kompanive deklarojnë për xprimm.com se në 2013 më shumë se 1000 makina luksoze janë vjedhur në Bullgari dhe kjo ka shënuar një rritje 82% krahasuar me një vit më parë në pagesat e kompensimit.

Megjithatë, përkundër këtij trendi të raportuar nga siguruesit, gjatë 11 muajve të parë të vitit 2013, shuma e përgjithshme e dëmeve Kasko të paguara ka rënë nga 270 milionë leva (monedha bullgare, afërsisht 135 milion euro) dhe në nëntor 2013 në rreth 252 milionë leva.

GREQI

www.xprimm.com

Drejtues të shoqërive të sigurimit deklarojnë për xprimm.com se për shkak të ndikimit të krizës ekonomike në buxhetet e familjeve, rreth një milion automjete janë aktualisht në qarkullim të pa siguruara në Greqi.

Ata theksojnë se autoritetet së shpejti do të prezantojnë një software (program kompjuterik) për kontrollin e identifikimit të shkelësve. Qeveria po përgatit legjislacionin që parashikon se nuk do të rinovohet asnjë kontratë, nëse shoferët nuk kanë paguar taksat e tyre.

RUSI

www.xprimm.com

Në Rusi është propozuar legjislacioni që ka të bëjë me sigurimin për rreziqet hapësinore, i cili mund të bëhet sigurim i detyrueshëm. Nëse gjithçka shkon sipas planit, kjo kërkesë mund të hyjë në fuqi në vitin 2015.

Sipas propozimit, agjencia federale hapësinore ruse dhe autoritetet ekzekutive federale të interesuara do të duhet të hartojnë një plan të cilit duhet ti bashkëlidhet edhe një faturë financiare mbi këtë projekt në nëntor të vitit 2014.

Bisedimet për sigurimin e detyrueshëm të rrezikut në hapësirë kanë filluar në vitin 2013, pas shpërthimit të një raketë Proton-M pak pas nisjes.

RUMANI

www.xprimm.com

Drejtuës të kompanive deklarojnë për xprimm.com se tregu i sigurimeve të Jetës në Rumani në 2013 ishte nën nivelin e arritur, në 2012. Gjatë vitit 2012 tregu i sigurimeve të Jetës kishte një vlerë rreth 404 milion euro. Ata vlerësojnë që edhe gjatë vitit 2014, ky treg pritet të rritet me më pak se 5%

Në nëntë muajt e parë të vitit 2013, vetëm kompania ING (Commercial Banking) ka nënshkruar rreth 92 milionë euro në prime, ndërkohë që fitimi bruto arriti në 3 milion euro.

QIPRO

www.xprimm.com

Kriza financiare që goditi Qipron në vitin 2012 e ka rënduar ekonominë e vendit, por nga ana tjetër, mund të ketë krijuar edhe mundësi më të mëdha për sektorin e sigurimeve. Edhe pse ekspertë të shoqërive të sigurimit kanë këmbëngulur se ata të gjithë e dinin se rënia e ekonomisë dukej në horizont, vetëm disa shoqëri ishin të përgatitur për një ngjarje të tillë shkatërruese. Qeveritë e njëpasnjëshme gjatë kësaj periudhe kanë qenë të fajësuar për mospërditësimin e kuadrit rregullator dhe frenimin e shpenzimeve të tepërta në mënyrë që të përgatiteshin për rënien eventuale.

Turqia, Rusia, Polonia dhe Republika Çeke, me mundësitë më interesante për rritje në industrinë evropiane të sigurimeve

www.xprimm.com

Kompanitë e sigurimeve Global, të cilat kërkojnë të zgjerojnë bizneset e tyre, janë gjithnjë në kërkim të një valë të re të tregjeve që kanë rritje të shpejtë. Në grupin e vendeve me rritje të shpejtë deri tani janë përfshirë ekonomitë e quajtura BRIC (*një grupim që i referohet vendeve si Brazili, Rusia, India dhe Kina*). Në panoramën aktuale Evropiane, janë konsideruar si tregje interesante për zhvillim të shpejtë edhe Turqia, Rusia, Polonia dhe Republika Çeke. Ky studim është bërë nga Analistët e Ernest & Young, (EY) një firmë shumëkombëshe e shërbimeve profesionale me zyrat qendrore të vendosur në Londër dhe që është gjithashtu një ndër katër firmat më të mëdha të kontabilitetit dhe mbajtjes së bilanceve (*"Big Four" accounting firms*).

Studimet e EY tregojnë që Kina do të vazhdojë të luajë një rol dominant në rritjen e primeve në nivel ndërkombëtar, por tregjet e reja në zhvillim si Meksiko, Tajlanda, Kolumbia dhe Indonezia janë duke ofruar mundësi të vlefshme afatgjata.

Studimi i kryer nga analistët e EY paraqet një matricë rrezik-mundësi duke renditur 21 tregje me rritje të shpejtë në kuptimin e perspektivave të tyre të ardhshme për siguruesit, bazuar në projektet ekonomike dhe rritjen e primeve deri në vitin 2020, stabilitetin financiar, ndryshime në rregullator, luhatshmërinë makroekonomike, rrezikun e likuiditetit dhe faktorë të tjerë.

Mundësitë për zgjerim global në tregjet e reja, përfaqësojnë një forcë të fuqishme duke përsheptuar rritjen e primeve të sigurimit veçanërisht në vende të zhvilluara në të cilën ecuria ekonomike është në vështirësi.

Sigurimet Kasko më të shtrenjta në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore

www.xprimm.com

Primi i sigurimit Kasko ndikohet nga mjaft faktorë, ku përveç të tjerash janë edhe frekuenca e lartë e dëmeve, infrastruktura rrugore apo edhe niveli i lartë i kërkesave për kompensim. Sipas analizës së fundit të kryer nga publikimet xprimm, për pronarët e makinave në Rumani, Rusi dhe Ukrainë çmimet janë ndër më të lartat në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore. Studimi u realizua duke shqyrtuar faqet e internetit që krahasojnë çmimet Kasko të sigurimit motorik në tetë shtete të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Llogaritjet kanë dalë duke gjetur çmimet më të lira dhe ato më të shtrenjta për një policë Kasko, për një individ 30 vjeçar, banor i kryeqytetit, i martuar, pa fëmijë, pronar i një automobili Ford Focus 1.6iTi-VCT, i vitit 2008. Llogaritjet janë kryer në janar 2014. Vlen të përmendet se në rastin e Ruisë, Ukrainës, Moldavisë dhe Bullgarisë, çmimet e ofruara nga aplikimet online janë dhënë për një shumë sigurimi prej 6,300 euro të kërkuar nga pronari.

Për këtë numër punuan:

R. Guri, D. Kalaja, P. Berberi, R. Eltari, Dh. Hazbiu, E. Beqir-Aga, E. Kokona